

BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR



European
Investment
Bank

The EU bank



Werner Hoyer
President i BEI-së



Dario Scannapieco
Zëvendës President
i BEI-së

Ballkani Perëndimor është një pjesë thelbësore e historisë evropiane. Kultura, arti dhe ekonomia e këtij rajoni kanë kontribuar në trajtësimin e Evropës.

Banka Evropiane e Investimeve, e cila është krahu financiar i Bashkimit Evropian, ka qenë aktive në Ballkanin Perëndimor që prej vitit 1977. Ne jemi financuesi më i madh ndërkombëtar në rajon. Pas trazirave të viteve '90 në vendet e Ballkanit Perëndimor, BEI-ja ka intensifikuar përpjekjet për ta nxitur këtë rajon drejt integritimit evropian.

Në fundin e viteve '90, financimi u përqendrua te ndërtimi me urgjencë dhe riparimi i urave, hekurudhave, porteve, aeroporteve dhe rrugëve të dëmtuara. Ne kemi punuar çdo vit me qeveritë, komunat, bashkitë dhe kompanitë në rajon, si dhe me Komisionin Evropian dhe partnerë të tjerë financiarë. Ne dëshirojmë të përmirësojmë jetën e njerëzve nëpërmjet rindërtimit të infrastrukturës, duke e ndihmuar rajonin që të modernizohet më tej dhe të bëhet i vetë-mjaftueshëm.

Gjatë dekadës së fundit, BEI-ja ka shtrirë huadhënien e saj në sektorë të tillë si kujdesi shëndetësor dhe arsimi, ndërkohë që ka adresuar edhe krizën botërore të migrimit. Sfida më e rëndësishme për të ardhmen është ndihmimi i njerëzve për një jetë më të mirë. Ne dëshirojmë të krijojmë fuqi punëtore të kualifikuar, zhvillues, shkencëtarë, ekonomistë, inxhinierë, avokatë dhe mësues të talentuar.

Për të luftuar krizën globale ekonomike dhe financiare dhe për të vazhduar nxitjen drejt rikuperimit, BEI-ja ka rritur mbështetjen për bizneset e vogla dhe autoritetet vendore përmes linjave kreditore me bankat vendore dhe kompanitë e qirave financiare (leasing). Bizneset e vogla janë shtylla e ekonomisë. Garantimi i qasjes në huamarrje afatgjatë ka rëndësi thelbësore për zhvillimin e tyre.

Duke marrë parasysh shkallën e sfidave, BEI-ja ka shpallur publikisht Nismën për Rimëkëmbjen Ekonomike (ERI-Economic Resilience Initiative), program me anë të të cilit ndihmohen vendet fqinje të BE-së që të përmirësojnë ekonomitë dhe t'i përgjigjen krizës së emigrimit. ERI-ja inkurajon më tej zhvillimin e biznesit të vogël dhe i ndihmon vendet të përmirësojnë infrastrukturën, gjithashtu përmes sigurimit të burimeve të granteve, falë donatorëve tanë.

Ne jemi të përkushtuar për të përmirësuar kushtet e jetesës dhe standardet ekonomike për të gjithë njerëzit që jetojnë në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi. Ne do të sigurojmë që e ardhmja e Ballkanit Perëndimor të jetë pjesë e së ardhmes së Evropës.

BANKA EVROPIANE E INVESTIMEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR

BEl-ja ofron shërbime financiare, kombinimesh dhe këshilluese në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë*, Mal të Zi, Maqedoninë e Veriut dhe Serbi

VENDET KANDIDATE

Shqipëria
Mali i Zi
Maqedonia e Veriut
Serbia

VENDET KANDIDATE POTENCIALE

Bosnja dhe Hercegovina
Kosova^[*]

PBB-ja totale
94,2 miliardë euro^[1]

Popullsia
19,9 milion

Sipërfaqja
218.750 km²

**NËNSHKRIMET E REJA
NË RAJON, 2018**
**FINANCUAR GJITHSEJ
QË PREJ VITIT 2008**

1,09 miliardë euro

7,65 miliardë euro



^[*] Ky përcaktim është pa paragjykim ndaj qëndrimeve mbi statusin dhe është në përputhje me UNSCR 1244/1999 dhe Opinionin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë për shpalljen e pavarësisë së Kosovës

HYRJE

BEl-ja e ka zgjeruar punën e saj në Ballkanin Perëndimor në shumë fusha dhe ka filluar të ndihmojë sektorin privat, duke mbështetur investimet e huaja të drejtpërdrejta dhe duke ofruar ndihmë për ndërmarrjet e vogla. Kompanitë e vogla janë të rëndësishme për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës.

Në vitin 2018, ne nënshkruam marrëveshje me vlerë 1,09 miliardë euro kredi në rajon. Në 10 vitet e kaluara, ne kemi ofruar një financim prej 7,65 miliardë eurosh për projekte.

AKTIVITETI I BEI-SË NË BALLKANIN PERËNDIMOR (2008-2018)

NËNŠKRIMET Vëllimi	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014	2015	2016	2017	2018	GJITHSEJ (m €)
Shqipëria		10	50,8		35	5,3	18				105	224
Bosnja dhe Hercegovina	280	150	72	180	206	212,7	172,5		130		242	1.650
Maqedonia e Veriut	10	100	52,34	125	110	103			45		100	645
Kosova	87					10		42			80	219
Mali i Zi	50	108	49,2	18	45	7	75	50	55,5	120	141	719
Serbia	170	887,9	760,2	710,6	275	317,8	115	130	196	210	418	4.190
GJITHSEJ (m €)	597	1.255,9	984,54	1.033,6	671	655,8	380,5	222	426,5	330	1.090	7.650

BEI-ja ndjek objektivin e BE-së për të ndihmuar Ballkanin Perëndimor drejt integritimit të shpejtë në Bashkimin Evropian.

Rritja e PBB-së në Ballkanin Perëndimor është duke u përshpejtuar që nga viti 2014, e nxitur nga investimet dhe konsumi privat. Rritja e PBB-së në rajon pritet të ruajë normën aktuale për vitet e ardhshme, me një rënie të përkohshme në 3,4% në vitin 2019 për shkak të ekonomisë sfiduese ndërkombëtare dhe përfundimit të projekteve të mëdha të infrastrukturës ^[1].

Fuqizimi i ekonomisë po krijon më shumë vende pune në sektorin privat: shkalla vjetore e punësimit është rritur me më shumë se 2% në vit, ndërkohë që shkalla e papunësisë ka zbritur nga 20,7% që ishte në vitin 2014 në 14,8% në vitin 2018. Shkalla e papunësisë është ende e lartë në përgjithësi, veçanërisht tek të rinjtë, e cila po dëmton standardet e jetesës në disa vende dhe po e bën më të qartë se kemi nevojë për reforma më të thella strukturore.

Strategjia e Komisionit Evropian për Ballkanin Perëndimor përcaktoi në fillim të vitit të kaluar se si duhet të përmirësohet rajoni në fusha të tilla si sundimi i ligjit, siguria, lidhshmëria, digjitalizimi, dhe zhvillimi ekonomik e konkurrueshmëria.

Kriza e fundit e migracionit ka krijuar sfida të reja dhe ka theksuar nevojën për bashkëpunim më të ngushtë rajonal. Kjo do të ndihmonte rajonin të përshtatet me sfidat e reja.

Banka mbështet plotësisht strategjinë e zgjerimit të Komisionit Evropian të shpallur në vitin 2018. Kjo do të rrisë mbështetjen në rajon për zhvillimin socio-ekonomik, lidhshmërinë dhe teknologjinë.

[1] Llogaritjet e stafit të BEI-së mbështetur në Institutin e Vjenës për Studime Ekonomike Ndërkombëtare (baza e të dhënave "WIW"), parashikimi i FMN-së.



ÇFARË BËJMË NE

BEl-ja u ofron vendeve të Ballkanit Perëndimor hua, grante dhe ekspertizë në katër fusha kryesore: inovacion, biznese të vogla, infrastrukturë dhe klimë. Ne kombinojmë kredi me investime nga organizata të tjera, dhe ekspertët e shërbimeve tona këshilluese sigurohen që projektet të zbatohen dhe të kenë sukses.

TRI SHTYLLA

HUADHËNIA

Ne përdorim fuqinë tonë financiare për të mbledhur para me norma të mira. Ne i përdorim kursimet për të dhënë kredi për projekte me cilësi të lartë

KOMBINIMI

Në bashkëpunim me partnerë të tillë si Komisioni Evropian, ne i ndihmojmë klientët të kombinojnë financimin tonë me investime nga burime të tjera

SHËRBIME KËSHILLIMORE

Ne ofrojmë një paketë të larmishme asistence teknike për projekte të mëdha infrastrukturore në sektorin publik dhe një gamë të gjerë investimesh në sektorin privat



**Huadhënia e BEI-së
80 milion euro**

Rruga 6, Kijevë-Pejë (Kosovë*)


Projekti përfshin ndërtimin e një segmenti autostrade prej 30 kilometrash, me dy korsi, sipas standardeve evropiane. Segmenti ndodhet në rrjetin gjithëpërfshirës të zgjeruar "TEN-T" midis kryeqytetit të Kosovës*, Prishtinës, dhe qytetit të katërt më të madh, Pejës. Duke pasur parasysh se 95% e mallrave dhe pasagjerëve në vend qarkullojnë përmes transportit rrugor, ky rrjet është vendimtar për zhvillimin ekonomik të Kosovës* dhe për integrimin rajonal të vendit.

Gjatë viteve të fundit, ka pasur një rritje të qëndrueshme dhe të konsiderueshme të qarkullimit në rrugë, e cila tani përdoret nga rreth 15 000 automjete në ditë, duke përfshirë edhe një numër të konsiderueshëm automjetesh të rënda. Ky projekt do të shmangë pjesën më të madhe të trafikut nga rruga ekzistuese, duke përmirësuar në këtë mënyrë shpejtësinë, sigurinë dhe mjedisin për shumë prej vendbanimeve që ndodhen pranë autostradës aktuale. BEI-ja do të kontribuojë me deri në 80 milionë euro në formë kredie. Projekti ka marrë 3,2 milionë euro në formën e granteve të Kornizës së Investimeve në Ballkanin Perëndimor dhe rruga pritet të përfundohet në fund të vitit 2021.

HUADHËNIA

Huadhënia është aktiviteti ynë kryesor. Ne mbështesim projekte që ndihmojnë dukshëm rritjen, punësimin, kohezionin rajonal dhe qëndrueshmërinë.

OPERACIONET E BEI-SË TË NËNSHKRUARA NË BALLKANIN PERËNDIMOR (2008-2018)



Burimet: Llogaritjet e personelit të BEI-së, mbështetur në bazën e të dhënave "WIW" dhe zyrat kombëtare të statistikave.

TRANSPORTI

Ka një nevojë të madhe për investime në infrastrukturën e transportit. Vendet e Ballkanit Perëndimor kanë mesatarisht 54 kilometra rrugë për çdo 100 kilometra katrorë tokë, krahasuar me rreth 126 kilometra rrugë për çdo 100 kilometra katrorë tokë në vendet e Evropës Qendrore dhe Juglindore në BE, me përjashtim të Rumanisë dhe Bullgarisë. Qeveritë e vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe Komisioni Evropian e kanë bërë prioritet përmirësimin e lidhjeve të transportit deri në vitin 2020. Qëllimi është të përmirësohen lidhjet midis vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe ato me BE-në.

BEI-ja po përdor financimet e veta për t'i përkrahur këto prioritet. BEI-ja është duke financuar autostrada dhe rrugë në korridoret prioritare në Serbi dhe Maqedoninë e Veriut, si dhe në Bosnje e Hercegovinë. BEI-ja ka ofruar kredi në shuma të konsiderueshme për rrugë dhe autostrada. Për të zhvilluar një sistem më të qëndrueshëm e më të shumëllojshëm transporti në rajon, janë nënshkruar ose janë në fazën e vlerësimit disa projekte të reja për vënien në funksionim të hekurudhave.

ENERGJIA

Prodhimi i energjisë elektrike në Ballkanin Perëndimor vjen kryesisht nga centralet me qymyr linjit (mbi 55%) dhe hidrocentralet (mbi 35%). Ndonëse linjiti që nxirret brenda vendit i jep rajonit siguri, në aspektin e furnizimit, ky lloj qymyri emëton nivele të konsiderueshme të gazit serë dhe ndotës të tjerë.

Ka shumë potencial për projekte të efikasitetit të erës, diellit dhe llojeve të tjera të energjisë në rajon.

Huadhënia e BEI-së në sektorin e energjisë përbën një pjesë të vogël të aktivitetit të Bankës në Ballkanin Perëndimor (rreth 5%, krahasuar me 15% brenda BE-së dhe 25% jashtë BE-së). BEI-ja është duke shqyrtuar aktivisht mundësitë për efikasitetin e energjisë dhe projektet e energjisë së ripërtërishme.

BEI-ja është duke marrë pjesë në programin pilot të udhëhequr nga Komisioni Evropian për të rritur efikasitetin e energjisë në Serbi dhe po vlerëson investimet potenciale në parqet eolike.

BEI-a po financon gjithashtu Gazsjellësin Trans-Adriatik, i cili do të kalojë nga kufiri greko-turk drejt Italisë përmes Shqipërisë. Ky gazsjellës do të transportojë deri në 10 miliard m³ gaz në vit dhe do të përmirësojë sigurinë e energjisë dhe shumëllojshmërinë.

Huadhënia e BEI-së
200 milionë euro

FUQIA PUNËTORE E KUALIFIKUAR

Ballkani Perëndimor vuan nga mungesa e punëtorëve të kualifikuar, inovacionit, energjisë dhe infrastrukturës strategjike. Ka mungesë fondesh të përshtatshme për kërkimin dhe institucionet e trajnimit për të aftësuar njerëzit dhe për t'i përgatitur ata për sfidat e së nesërme. Rajoni renditet në vendin e 77-të nga 140 vendet në Treguesin e Konkurrencës të Forumit Ekonomik Botëror, me një rezultat të ulët në inovacion dhe sofistikimin e biznesit.

MJEDISI

Pavarësisht rritjes së ndërgjegjësimit rreth nevojave kritike për investime, zhvillimet në infrastrukturën mjedisore të Ballkanit Perëndimor kanë qenë të ngadalta.

Shumë sektorë vazhdojnë të jenë të fragmentuar, ndërkohë që për shkak të qeverisjes së dobët, infrastruktura mirëmbahet keq dhe nuk është aspak efikase. Ligjet që imponojnë kufizimet për ndotjen dhe përmirësojnë standardet e shërbimeve janë ose të pamjaftueshëm ose nuk respektohen plotësisht.



Huadhënia e BEI-së
19 milionë euro

Mbrojtja nga përmbytja në Bosnje dhe Hercegovinë

Përmbytjet e vitit 2010 të lumit të Savës në Bosnje dhe Hercegovinë shkaktuan dëme të mëdha. Shumë diga, kanale, shtretër lumenjsh dhe stacione pompimi që nuk u dëmtuan gjatë përmbytjeve janë disa prej objekteve më të rrezikuara.

Një përmbytje tjetër do të vinte në rrezik të madh njerëzit, shtëpitë, industrinë dhe fermat. Në kuadër të Nismës për Rimëkëmbjen Ekonomike, BEI-ja do të ofrojë 19 milionë euro për ndërtimin e objekteve mbrojtëse përgjatë lumit të Savës dhe përrrenjve e kanaleve që derdhen në të.

Huadhënia e BEI-së
500 milionë euro

PRODHIMI DHE INVESTIMET E HUAJA TË DREJTPËRDREJTA

Prodhimi është vatër kryesore e inovacionit dhe prodhimtarisë në Ballkanin Perëndimor. Industritë prodhuese shpeshherë ndihmojnë për të tërhequr drejt rajonit investime të huaja të drejtpërdrejta në masë të konsiderueshme. Megjithatë, përparimi i shpejtë teknologjik po ndryshon peizazhin e prodhimit dhe inxhinierisë në nivel botëror. BEI-ja është zotuar të investojë në sektorin e prodhimit rajonal për të siguruar që vendet e Ballkanit Perëndimor të mbeten konkurruese në prodhim dhe teknologji të përparuar.

Makinat e vogla “Fiat”, Serbi

BEI-ja i ka ofruar 500 milionë euro investime kompanisë “Fiat Chrysler Automobiles” (FCA) për të rinovuar, modernizuar dhe zgjeruar fabrikën e automjeteve të kompanisë në Kragujevac të Serbisë. Kjo ka rritur kapacitetin e prodhimit nga 30 000 në mbi 180 000 automjete. Financimi i BEI-së ka mundësuar prodhimin e një familjeje të re të automjeteve të segmentit “B” në këtë fabrikë.

Deri tani, ky është investimi më i madh në historinë e industrisë së Serbisë dhe ka ndihmuar për të shndërruar kantierin e vjetruar industrial në një prej fabrikave më moderne të FCA-së. Ky projekt u nis me qëllim zhvillimin e një platforme konkurruese prodhimi në një vend që ka mundësi të anëtarësohet në të ardhmen në BE dhe rrënjosjen e një kulture të fuqishme industriale me fuqi punëtore të kualifikuar, të mirë-arsimuar dhe konkurruese.

Projekti ka kontribuar në rritjen e investimeve të drejtpërdrejta të huaja në Serbi dhe ka ndihmuar në zhvillimin e industrisë së automobilave dhe nxitjen e zhvillimit teknologjik në vend. Kjo ka rritur prodhueshmërinë vendase dhe eksportet, duke fuqizuar zhvillimin ekonomik të Serbisë. Projekti ka mbështetur furnizuesit vendas të FCA-së, ka ndihmuar në ruajtjen e vendeve të punës në fabrikën e Kragujevacit dhe ka rritur drejtpërdrejt punësimin vendas e ka krijuar tërthorazi vende të tjera pune.

BIZNESET E VOGLA

Grupi i BEI-së ofron një numër instrumentesh financiare për bizneset e vogla në të gjithë Ballkanin Perëndimor.

BEI-ja u jep kredi bankave vendore dhe ndërmjetësve të tjerë, të cilët më pas u japin kredi bizneseve të mesme dhe të vogla. Në Mal të Zi, BEI-ja po ofron 320 milion euro për të promovuar rritjen e sektorit privat dhe për të siguruar qasje të përshtatshme në financa për firmat e vogla. Në Bosnjë dhe Hercegovinë, BEI-ja po ofron 25 milion euro për një kompani të qirasë financiare (leasing) për të financuar kompanitë e vogla dhe mbështetur projekte në turizëm, bujqësi, kujdes shëndetësor, arsim dhe mjedis. Operacioni do të përqendrohet gjithashtu në punësimin e të rinjve në kuadër të nismës evropiane për Punësimin dhe Trajnimin e Rinisë për Ballkanin Perëndimor (EYET). Kredia do të mbështesë rreth 4.450 vende pune dhe 445 firma të vogla.

Fondi Evropian i Investimeve, i cili është pjesë e Grupit BEI, specializohet në financimin e rrezikut për bizneset e vogla. FEI-ja u ofron garanci ndërmjetësve kreditorë me qëllim nxitjen e huadhënies ndaj firmave të vogla, dhe angazhon burime financiare për fonde private të kapitalit që përqendrohen tek investimet në firma të vogla.

Në Ballkanin Perëndimor, FEI-ja ka pasur një prezencë të qëndrueshme që prej vitit 2012, me krijimin e Instrumentit për Sipërmarrje dhe Inovacion në Ballkanin Perëndimor (WB EDIF), i cili synon përmirësimin e qasjes së kompanive të vogla në financim. Sipas instrumentit "WB EDIF", FEI-ja vepron si instrument garancie që u ofron mbrojtje kundër humbjeve të para ndërmjetësve financiarë në lidhje me humbjet që kanë ndodhur në portofolin e përzgjedhur.


Ballkani Perëndimor
18 NVM për
1000 njerëz

Deri më tani kjo ka nxitur dhënien e kredive në rajon në vlerën prej rreth 228 milionë eurosh, me kushte më të favorshme sesa ato të tregut vendas. Në vitin 2018, FEI-ja përzgjodhi pesë banka sipas një alternative të posaçme të instrumentit, dedikuar vetëm për Serbinë dhe parashikohet të gjenerojë kredi në vlerë më të madhe sesa 180 milionë euro për kompanitë e vogla.

Duke filluar nga viti 2016, shumica e vendeve të Ballkanit Perëndimor janë kualifikuar për instrumentet financiare EU-28 të përkrahjes ndaj kompanive të vogla, të tilla si: Konkurrenca e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME), Innov-Fin dhe Punësimi dhe Inovacioni Social (EaSI), të cilat ofrojnë burime përkatësisht për firmat me rrezik, novatore dhe mikro. Deri në fund të 2018, FEI-ja ka lidhur 29 marrëveshje garancie në kuadrin e këtyre programeve, duke nxitur kështu kredi të reja për firmat e vogla në vlerë prej 900 milionë eurosh në rajon.

FEI-ja ka qenë pioniere edhe e krijimit të fondeve private të kapitalit në rajon, duke përzgjedhur menaxherin e parë të fondeve të përqendruar plotësisht në rajon dhe duke investuar përmes platformës "WB EDIF" në fondin e vet të parë: "Fondi i Inovacionit për Sipërmarrjet" – ENIF. ENIF-i ka rreth 40 milionë euro dhe përqendrohet te kompanitë novatore dhe ato të teknologjisë në fazat e tyre të hershme të rritjes.

Bashkimi Evropian,
48 NVM për
1000 njerëz

An aerial photograph of a large, multi-faceted stone structure built on a rocky cliffside overlooking the sea. The structure has several large, flat, rectangular sections and is surrounded by dense green vegetation. The sea is visible on the left side of the image, with a clear turquoise color near the shore.

BEl-ja dha **45 milion euro** për të mbështetur investimet në Shërbimet e Trafikut Ajror në Serbi dhe Mal të Zi. Investimet do të përmirësojnë kapacitetin, sigurinë, efikasitetin e kostos dhe pajtueshmërinë me rregulloren e BE-së, dhe gjithashtu do të forcojnë lidhjen e transportit ajror.

NISMA PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

BEl-ja ka intensifikuar përkrahjen e vet për fqinjësinë e BE-së, sidomos fqinjësinë me vendet jugore dhe me vendet e Ballkanit Perëndimor, në drejtim të rritjes ekonomike dhe realizimit të qëllimeve për zhvillim të qëndrueshëm. Nevoja për këtë përkrahje shtesë është vënë në pah pas krizës së migracionit, e cila ka krijuar më shumë sfida zhvillimore në këto rajone, duke vënë kështu në pikëpyetje aftësinë rimëkëmbëse ekonomike të një numri vendesh. Rritja e aftësisë ekonomike për t'u rimëkëmbur kërkon përditësimin dhe zhvillimin e infrastrukturës sociale dhe ekonomike dhe nxitjen e rritjes së sektorit privat dhe krijimin e vendeve të punës.

Nisma për Rimëkëmbjen Ekonomike e BEI-së shënon një ndryshim të madh në përkrahjen e BEI-së për këta dy fqinjë. Financimet tona i kemi rritur me 6 miliardë euro gjatë një periudhe pesë vjeçare që nisi në vitin 2016 – krahas 7.5 miliardë eurove që janë parashikuar tashmë – për të nxitur deri në 15 miliardë euro investime të tjera në të dy rajonet.

Në Ballkanin Perëndimor, ERI-ja është duke ndihmuar tashmë infrastrukturën jetike dhe krijimin e vendeve të punës.

35
milion euro

Në **Serbi**, BEI-ja miratoi një kredi prej 35 milion eurosh për të përmirësuar sistemin e kanalizimeve në Beograd, duke përmirësuar jetën e 170,000 njerëzve në rrethin e Palilula. Projekti, i cili përfshin një grant prej 1,1 milion eurosh asistencë teknike nga Nisma për Rimëkëmbje Ekonomike, siguron një infrastrukturë jetike për qytetin dhe shton një impiant të ri për trajtimin e ujërave të zeza që do të zvogëlojë ndotjen në lumin Danub dhe ujërat nëntokësorë.

Në **Shqipëri**, infrastruktura bazë, ku përfshihet transporti, energjetika dhe mjedisi, ka pësuar sforcim të konsiderueshëm pas krizës së migracionit. Përmes ERI-së, do të ofrohen 29.5 milionë euro financime për të ruajtur infrastrukturën jetike ndaj presioneve të ardhshme në rast se rritet fluksi i emigrimit. Ky projekt do të përmirësojë edhe lidhjet e Shqipërisë me pjesën tjetër të rajonit.

29.5
milion euro

Në **Mal të Zi**, BEI-ja dha 40 milion euro për rehabilitimin e pesë rrugëve kryesore, një e katërta e rjetit kombëtar. Projekti do të përmirësojë kushtet dhe sigurinë e rrugës gjë e cila do të ndihmojë tregtinë dhe integrimin rajonal. Punimet përfshijnë rindërtimin e disa urave dhe tuneleve. Projekti gjithashtu do të marrë një grant prej 1,5 milion eurosh për ndihmë teknike ERI, **granti i parë ERI i dhënë një projekti në Ballkanin Perëndimor**. Granti do të mbështesë shërbimet e specializuara, të nevojshme për mbikëqyrjen e punimeve në rrugë.

BEI-ja planifikon **operacione financimi të ndikimit** për të adresuar sfidat sociale në Ballkanin Perëndimor. Në këto sfida bëjnë pjesë: papunësia, varfëria, qëndrueshmëria e NVM-ve, ndryshimi klimaterik, qasja në burimet bazike dhe integrimi ekonomik e social i grave dhe të rinjve.



FONDI I NISMËS PËR RIMËKËMBJEN EKONOMIKE

Fondi i Nismës për Rimëkëmbjen Ekonomike (ERIF) synon të sigurojë mbështetje shtesë për operacionet e ERI në formën e granteve për investime ose përmes instrumenteve financiare duke përdorur kontributet e donatorëve. Fondi siguron financim koncesionar për infrastrukturën jetësore dhe mbështet investime me rrezik më të lartë ose me fitim më të ulët financiar për të rritur ndikimin social dhe ekonomik.

Në Shqipëri, Fondi ka siguruar financim të donatorëve në vlerë prej 2,4 milion eurosh për rihvillimin urban të lumit të Lanës. Zona është në rrezik të lartë nga përmytja, kështu që banorët janë nën kërcënim të vazhdueshëm. Projekti do të përmirësojë kushtet shëndetësore, sanitare dhe të sigurisë nga përmytja në Tiranë për rreth 65,000 njerëz.

Rinovimi i nënstacioneve të energjisë elektrike në Serbi

Projekti me EMS-në, operator i energjisë elektrike në Serbi, ka ndihmuar në ndërtimin dhe rehabilitimin e gjashtë nënstacioneve të energjisë elektrike. Nënstacionet u lidhen me rrjetin përmes pesë linjave të tensionit të lartë, të cilat arrijnë gjithsej në 45 kilometra gjatësi.

Projekti përfshinte projektimin, ndërtimin dhe vendosjen në punë të nënstacioneve. Për të përdorur paratë e kursyera nga ky projekt, planifikuesit i shtrinë punimet për të përfshirë sistemet e mbrojtjes dhe kontrollit në pesë nënstacione të tjera.

Projekti i nënstacionit "Beograd 3", për shembull, është i rëndësishëm sepse ky nënstacion furnizon me energji elektrike një pjesë të madhe të Beogradit. Ky nënstacion ndodhet në Rakovicë, rreth 10 kilometra në jug të Beogradit. Nënstacioni, i cili filloi punën në vitin 1953, është një prej nënstacioneve më të vjetër 220/110 kV në rrjetin e Serbisë. Rehabilitimi përfshinte zëvendësimin e çelësave 110 dhe 220 kV, të cilët kishin arritur fundin e jetës së tyre teknike. Rehabilitimi u përfundua në korrik të vitit 2014 dhe u krye ndërkohë që nënstacioni ishte në punë. Financimi i BEI-së ka shkuar për çelësat 110/220 kV dhe për sistemin e kontrollit dhe mbrojtjes.

275 milion euro janë investuar në EDIF për BP-në, duke përfshirë
150 milion euro të investuara nga BE, duke lëvruar rreth
715 milion euro për bizneset e vogla që nga krijimi.

4600 firma të vogla
do të mbështeten nën
WB EDIF.



KOMBINIMI

KORNIZA E INVESTIMEVE NË BALLKANIN PERËNDIMOR (WBIF)

Në Ballkanin Perëndimor, BEI-ja ofron një numër investimesh me partnerë.

Në vitin 2008, Këshilli i Çështjeve Ekonomike dhe Financiare kërkoi një Kornizë gjithëpërfshirëse të Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) "për të përmirësuar harmonizimin dhe bashkëpunimin në investime për zhvillimin socio-ekonomik të rajonit."

WBIF-ja filloi në dhjetor të vitit 2009, si nismë e përbashkët e Komisionit Evropian, Bankës Evropiane për Investime, Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Bankës për Zhvillim e Këshillit të Evropës (BZHKiE). Krijimi i kësaj nisme ishte përgjigje ndaj kërkesës së vendeve të Ballkanit Perëndimor për të integruar kushtet për asistencën e ofruar nga donatorë të ndryshëm. Grupi i Bankës Botërore, banka gjermane për Zhvillim KfW dhe Agjencia Franceze për Zhvillim janë bërë pjesë e WBIF-së.

WBIF-ja është një strukturë bashkëpunimi të shumanshëm dhe të hollësishëm që ofron asistencë teknike dhe grante për projekte infrastrukturore në Ballkanin Perëndimor. Ajo mbështet projekte që përmirësojnë konkurrencën dhe rritjen, ndërsa forcojnë bashkëpunimin rajonal dhe lidhshmërinë. Sektorët që kualifikohen për mbështetje janë energjia, mjedisi, sektori social, transporti dhe sektori privat e infrastruktura digjitale.

WBIF-ja mbledh grante nga buxheti i BE-së, disa donatorë dypalësh dhe institucionet financiare partnere.

Fondi i Përbashkët Evropian i Ballkanit Perëndimor luan një rol thelbësor në strukturën ligjore WBIF-së dhe është rezerva kryesore për shumicën e donatorëve të granteve. Ky fond bashkë-menaxhohet nga BEI-ja dhe BERZH-i.

Në shkurt të vitit 2018, KE-ja përmirësoi përkrahjen për Ballkanin Perëndimor duke konfirmuar rolin mbizotërues të WBIF-së në përkrahjen e politikave të anëtarësimit në BE. Për periudhën deri në vitin 2020, pritet që BE-ja t'i japë si kontribut WBIF-së edhe 400 milionë euro të tjera.

Viti 2019 shënon 10-vjetorin e WBIF-së. Komisioni Evropian ka filluar një fushatë "EU4You" në të gjithë Ballkanin Perëndimor për të treguar suksesin e përbashkët nën WBIF. BEI-ja do të vijojë të luajë një pjesë integrale në WBIF dhe të kontribuojë në një Ballkan Perëndimor më zhvilluar dhe të integruar.

KËSHILLIME

MBËSHTETJE PËR PROJEKTET E INFRASTRUKTURËS

Asistenca këshilluese dhe teknike e BEI-së mbështet përgatitjen dhe zbatimin e projekteve të investimeve prioritare në infrastrukturë në vendet e Ballkanit Perëndimor në sektorët e transportit, mjedisit, energjetikës dhe çështjeve sociale. Një ekip ekspertësh ndihmon me studime fizibiliteti, plane paraprake dhe të detajuara, procesin e tenderimit, mbikëqyrje të projekteve dhe studime të tjera përgatitore. Kjo mbështetje bashkëfinancohet nga Komisioni Evropian dhe BEI-ja dhe u ofrohet përfutuesve falas.

Si menaxhere e Instrumentit të Projekteve në Infrastrukturë, financuar nga WBFI-ja, BEI-ja shfrytëzon ekspertizën e konsulentëve të jashtëm të personelit të saj për të ndihmuar organet e sektorit publik që të rrisin mundësitë që projektet e tyre të marrin investime.

Përmes programit "JASPERS", BEI-ja ndihmon shtetet e Ballkanit Perëndimor të përgatisin strategji sektoriale dhe të hartojnë projekte kyçe në sektorët e transportit, mjedisit, energjetikës dhe zhvillimit të zgjuar. Kjo rrit edhe kapacitetet administratave vendase për të trajtuar projektet. Që nga viti 2013, JASPERS-i ka ndihmuar në përgatitjen e më shumë se 80 projekteve, për një investim të përgjithshëm prej 4 miliardë eurosh.

Edhe programi "EPEC" i BEI-së ndihmon vendet e BP-së për zhvillimin e Partneritetit Publik-Privat (PPP), duke u ofruar këshilla lidhur me ligjet për PPP-në dhe duke ndarë përvojën dhe praktikat më të mira për t'i ndihmuar autoritetet publike të realizojnë PPP-të më të mira.

MBËSHTETJE KËSHILLIMORE NDAJ BIZNESEVE TË VOGLA

Instrumenti për Sipërmarrje dhe Inovacion në Ballkanin Perëndimor, i cili financohet nga BE-ja, përmirëson qasjen në financim për kompanitë e vogla në Ballkanin Perëndimor. BEI-ja koordinon shërbimet këshillimore që ofrohen nga institucione financiare, si: Banka Botërore, OBEZH-i, BERZH-i dhe KfW-ja. Qëllimi është përmirësimi i mjedisit për biznes për firmat e vogla dhe nxitja e zhvillimit të kërkimit dhe inovacionit në rajon.

BEI-ja ka kryer së fundmi një studim për të identifikuar institucionet që kanë potencialin më të lartë për të pasur sukses në kërkim, zhvillim dhe inovacion. BEI-ja po punon me disa institucione për të identifikuar udhërrëfyesin që do t'i bëjë ato Qendra Rajonale Ekselence. Gjithashtu, Banka ka zbatuar një program përkrahjeje për të mbështetur firmat e vogla në përdorimin e aseteve të tyre të paprekshme dhe të drejtave të pronësisë intelektuale në zhvillimin e tyre. Në bashkëpunim me Qendrën e Bashkuar të Kërkimit të KE-së, BEI-ja po harton një program për përkrahjen, përmes granteve, të firmave të vogla novatore dhe organizatave të kërkimit dhe zhvillimit, për hartimin e "provave të konceptit (POC)".

Krahas kësaj, BEI-ja ka realizuar një studim për të vlerësuar nevojat e kompanive të vogla për financim, dhe ka këshilluar qeverinë e Serbisë për krijimin e instrumenteve financiare

novatore për firmat e vogla, duke përdorur burimet e IPA-s. Ky studim identifikoi nevojat e vendit në fushën e mikrofinancës, borxhit dhe tregjeve të kapitalit dhe propozoi një strategji investimi për adresimin e këtyre boshllëqeve. Realizimi në të ardhmen i një instrumenti përshpejtues për të ofruar financim në kapital dhe një instrumenti garantues të portofolit të NVM-ve, ku do të mund të përfshihen mikro-kreditë, po shqyrtohet tashmë nga qeveria e Serbisë.

MBËSHETJE KËSHILLUESE NË KUADËR TË NISMËS PËR RIMËKËMBJE EKONOMIKE TË BEI-SË

BEI-ja po ofron asistencë teknike në vlerë prej 90 milion eurosh për projekte në kuadër të Nismës për Rimëkëmbje Ekonomike. Kjo do të mbështesë zbatimin e projekteve që mbështesin zhvillimin ekonomik dhe shoqëror në Fqinjësinë Jugore dhe Ballkanin Perëndimor. Në Kosovë, një shumë prej 1 milion eurosh asistencë teknike e ERI-së po mbështet ndërtimin e një autostrade 30 kilometra të gjatë midis Pejës dhe Kijevës për të ndihmuar në përmirësimin e integritit rajonal të transportit.

HISTORI SUKSESI



NJË PREJ LINJAVE HEKURUDHORE MË TË BUKURA TË EVROPËS I RIKTHEHET SHKËLQIMIT TË DIKURSHËM

Hekurudha e Malit të Zi dikur ishte një prej arritjeve më të mëdha të vendit. Ishte projekti më i madh dhe më i kushtueshëm infrastrukturor në ish-Federatën Jugosllave. Por tani është shkatërruar.

Me ndihmën e Bankës Evropiane të Investimeve, planifikohet që hekurudhës t'i rikthehet lavdia e dikurshme. Në vitin 2017, BEI-ja miratoi një kredi 20 milionë eurosh për të rehabilituar linjën hekurudhore nga Bari në Vërbnicë, në kufirin me Serbinë. Kjo kredi do të kombinohet me grantin e parë të investimeve nga fondet e BE-së dhe Kornizën e Investimeve në Ballkanin Perëndimor (WBIF) në Mal të Zi.



Kur u hap në vitin 1976, rrjeti hekurudhor ishte fjala e fundit e teknologjisë: ai ishte po aq modern dhe i rehatshëm sa edhe çdo rrjet hekurudhor në botë. Gjithashtu, ishte një prej rrugëve më të bukura në Evropë, e cila lidhte kryeqytetin e Serbisë, Beogradin, me portin kryesor të Malit të Zi, Barin, në jugperëndim.

Mungesa e vazhdueshme e financimeve të duhura bëri që hekurudha të ndeshë në probleme të mëdha, madje që në fillim të viteve '90. Dikur, udhëtimi nga njëri skaj i hekurudhës në tjetrin zgjaste 7 orë, ndërsa tani pothuaj 11. Pjesa e hekurudhës në Mal të Zi është dëmtuar shumë për shkak të mungesës së mirëmbajtjes. Gjatë riparimeve, projekti i ri do të krijojë 1.000 vende pune në Mal të Zi. Projekti do të përmirësojë edhe lidhjet tregtare kryesisht me Serbinë dhe Rumaninë dhe do të ndihmojë turizmin.



FURRTARI IA DEL MBANË I VETËM: KTHEN FURRËN E BUKËS NË NJË PREJ MARKAVE MË KRYESORE KOMBËTARE

Në janar të vitit 1986, Ilija Pavlickovski mori një kredi për furrën e vogël të bukës në Shuto Orizari, komuna e dytë më e vogël e Shkupit, i cili është kryeqyteti i Maqedonisë së Veriut. Gjyshi dhe babai i tij kishin kaluar pjesën më të madhe të jetës duke punuar për prodhuesin më të madh të bukës dhe miellit në Maqedoni, “Zito Luks”-in. Por Ilija mendoi se kishte ardhur koha të hapte biznesin e vet. “Furra e bukës kishte një furrë druri të vogël. Në fillim mund të pëqinim rreth 500 bukë në ditë,” thotë ai. Sot, Ilija menaxhon një rrjet prej më shumë se 20 furrash të mëdha dhe 200 furrash të vogla në të gjithë vendin. Kompania e tij, “Bakery Dime”, është shndërruar në një markë që njihet në nivel kombëtar.

Kredia e financuar nga BEI-ja ndihmoi furrën “Bakery Dime” të rritej dhe të diversifikohej. Sot, në kompani janë të punësuar 202 njerëz, ndërkohë që para 10 vitesh, numri i të punësuarve aty ishte 82. Ilija dhe furra e tij e bukës, mori tri kredi të financuara nga BEI-ja në vlerë prej 1,45 milionë eurosh, përmes Bankës Maqedonase për Përkrahjen e Zhvillimit (BMPZH).

Aleksandar Stanojkovski, i cili punon në BMPZH, thotë se suksesi i Ilijës ka qenë pasojë e ambicies së tij për të marrë nën kontroll të gjithë procesin e prodhimit. “Në Maqedoni prodhimi i grurit është i pamjaftueshëm, kështu që duhet të importohet grurë nga jashtë vendit, i cili është me cilësi më të ulët,” thotë Stanojkovski, “dhe për këtë arsye, Ilija vendosi ta prodhonte vetë grurin.”

Tashmë kompania prodhon rreth 30.000 bukë në ditë, në mbi 500 furra buke, në të gjithë vendin.

Sot, në kompani janë të punësuar **202 njerëz**, ndërkohë që para 10 vitesh, numri i të punësuarve aty ishte **82**

RRETH NESH

BEI-ja është bankë e Bashkimit Evropian. Ne ofrojmë financim dhe ekspertizë për projekte të qëndrueshme investimesh. Në vitin 2018, Grupi "BEI" ofroi 64 miliardë euro për investime afatgjata në të gjithë Evropën dhe në botë.

Ekipi përgjegjës për Ballkanin Perëndimor ndodhet në selinë e BEI-së, në Luksemburg. Që prej vitit 2018, Banka ka shtuar staf në Shqipëri dhe Bosnje dhe Hercegovinë për të rritur praninë e saj vendase.

Ekipi ynë për Ballkanin Perëndimor mbulon një gamë të gjerë projektesh dhe përfshin ekspertë drejtues me përvojë të madhe në rajon.

Në vitin 2010, BEI-ja hapi një zyrë rajonale në Serbi për të menaxhuar marrëdhëniet institucionale në Ballkanin Perëndimor.



Banka Evropiane e Investimeve
98-100, bulevardi Konrad Adenauer
L-2950 Luksemburg
☎ +352 437 91
www.eib.org

🐦 twitter.com/EIB

📘 facebook.com/EuropeanInvestmentBank

📺 youtube.com/EIBtheEUBank

Miguel Morgado

Drejtor, Operacionet e Kredihënies
Departamenti për Detin Adriatik
☎ +352 437 986 446
✉ m.morgado@eib.org

Matteo Rivellini

Përgjegjës Divizioni, Operacionet e Kredihënies
në Ballkanin Perëndimor, Slloveni dhe Kroaci
☎ +352 437 988 417
✉ m.rivellini@eib.org

Marco Santarelli

Kontakti me shtypin, zyrtar i lartë për shtypin
☎ +39 064 719 1
✉ m.santarelli@eib.org

Dubravka Nègre

Përgjegjëse e Përfaqësisë Rajonale të BEI-së për Ballkanin
Perëndimor, Përfaqësia Rajonale për Ballkanin Perëndimor
Vladimira Popovića 38-40
11070 Beograd
☎ +381 113 121 756
✉ d.negre@eib.org

Sandrine Friscia

Përfaqësues i BEI-së për Bosnjën dhe Hercegovinën dhe Malin e Zi
Delegacioni i Bashkimit Evropian në BH, Skenderija 3a
71000 Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë
☎ +387 33 254 792
✉ s.friscia@eib.org

Alessandro Bragonzi

Përfaqësues i BEI-së për Shqipërinë, Maqedoninë e Veriut dhe
Kosovën*
Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri
ABA Business Centre, kati 17
Rruga Papa Gjon Pali II
Tiranë, Shqipëri
☎ +352 437 983 066
✉ a.bragonzi@eib.org